



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 03.02.2026, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me numër të referencës: YKOMMQ-0253, për ish zyrtarin e lartë Fatir Berzati, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Mitrovicës së Veriut, për shkak se në rastin konkret nuk është konstatuar situatë konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

## A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për situatë të mundshme të Konfliktit të Interesit, respektivisht papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik për ish zyrtarin e lartë Fatir Berzati, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Mitrovicës së Veriut, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë nga një raportues anonim (në vijim: raportuesi i rastit), me pretendimet se (citojmë nga kërkesa): “[...]Fatir Berzati njëkohësisht ushtron funksionin e drejtorit të inspektoratit dhe funksionin e drejtorit për shërbime publike dhe infrastrukturë në komunën e Mitrovicës së Veriut [...]”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ dhe në kuadër të saj, ka ndërmarrë veprime verifikuese lidhur me pretendimet e raportuesit të rastit për ish zyrtarin e lartë Fatir Berzati, duke kërkuar dhe administruar informacion zyrtar nga Komuna e Mitrovicës së Veriut, lidhur me ushtrimin eventual të funksioneve apo pozitave publike të zyrtarit në ljalë.

Nga informatat që përmban kërkesa e raportuesit të rastit, si dhe dokumentacioni i siguruar sipas detyrës zyrtare nga komuna e Mitrovicës Veriore, rezultojnë gjendja faktike si në vijim:

Me Vendimin nr.: 01-625/031, të datës 07.07.2023, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, Fatir Berzati është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturë, Inspektion dhe Situata Emergjente, deri në përfundimin e mandatit të kryetarit;

Me Vendimin ( për Plotësim-Ndryshimin e Vendimit Nr. 01-625/031 të datës 07.07.2023) nr.: 01-030/01-0011235/25, i datës 11.07.2025, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, ndryshohet pjesërisht Pika 1, e Vendimit Nr.01-625/031 të datës 07.07.2023, si në vijim: Largohen emërtimet e Drejtorive si: Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Situata Emergjente;

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar sqarim nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Veriut nëse emërimi i Fatir Berzati, referuar Vendimit të kryetarit të komunës së Mitrovicës së Veriut me nr.: 01-625/031 i datës 07.07.2023, në pozitën Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Infrastrukturë, Inspektion dhe Situata Emergjente, është bërë në kuadër të një drejtorie të vetme organizative, apo nëse këto fusha kanë funksionuar si njësi (Drejtori) të ndara brenda strukturës komunale;

Nga përgjigjja e pranuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Veriut rezulton se Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë, Inspektion dhe Situata Emergjente në të cilën ish zyrtari i lartë Fatir Berzati ishte emëruar me vendim të datës 07.07.2023 nga kryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut, ka funksionuar si një drejtori e vetme;

Ndërsa, përmes emalit zyrtar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve njerëzore në Komunën e Mitrovicës Veriore, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është njoftuar se ish zyrtari i lartë Fatir Berzati që nga data 05.12.2025, nuk mban më asnjë funksion publik në komunën e Mitrovicës Veriore.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të gjithanshëm të pretendimeve të raportuesit të rastit, dokumentacionit të siguruar sipas detyrës zyrtare nga Komuna e Mitrovicës së Veriut me kërkesë të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe provat tjera të siguruar sipas detyrës zyrtare, e në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konstatoi si në dispozitiv të këtij vendimi se, nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, në kuptim të dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, për faktin se ish zyrtari i lartë Fatir Berzati nuk ka ushtruar njëkohësisht funksionin e udhëheqësit të dy drejtorive në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

Pra, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka pasur parasysh dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për sa i përket kufizimeve, ndalesave e veçanërisht papajtueshmërive lidhur me ushtrimin e funksionit publik, por në rastin konkret, sikur u konstatua me sipër, zyrtari Fatir Berzati që me emërimin e tij (vendimin nr.: 01-625/031, i datës 07.07.2023 dhe vendimi për plotësim-ndryshimin e vendimit Nr. 01-625/031 i datës 07.07.2023, nr.: 01-030/01-0011235/25, i datës 11.07.2025), ka ushtruar funksionin e vetëm të një drejtorie, njëherë funksionin e Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike, Infrastrukturë, Inspektion dhe Situata Emergjente e më pas funksionin e drejtorit të Inspektionit, duke mos rënë ndesh kështu me dispozitat e sipërcituara të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Veriut
- Ish-Zyrtarit publik (subjekt i trajtimit për konflikt të interesit)
- Drejtorit të DPKI-së
- Zyrtares përgjegjëse

  
Yll Buleshkaj  
Drejtor i Agjencisë  
për Parandalimin e Korrupsionit